

VENDIM
Nr. 254, datë 20.5.2026

**PËR NDRYSHIMIN E VENDIMIT NR. 136, DATË 29.3.2023 TË KËSHILLIT TË
LARTË GJYQËSOR “PËR FILLIMIN E FUNKSIONIMIT TË GJYKATËS SË
SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM SHKODËR”**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 135, pika 1, 147, pika 1, 147/a, pika 1, shkronja “ë”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; në nenin 61, pika 2, shkronja “ë”, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar; në ligjin nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, pasi shqyrtoi nevojën për saktësimin e adresës së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër,

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 136, datë 29.3.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër”, neni 1, pika 3, adresa:

Rruga “Don Bosko”

zëvendësohet me:

Rruga “Et’hem Osmani”.

2. Të gjitha dispozitat e tjera të vendimit nr. 136, datë 29.3.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor mbeten të pandryshuara.

Ky vendim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR
KRYETAR
Ilir Rusi